

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.P. nga fsh. ..., K. e Gjilanit, për shkak të veprës penale Marrja e ryshfetit parashikuar me nenin 343 par.2 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.82/2013 datë 29.01.2015 në seancën e kolegjit të mbajtur me 12.12.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.82/2013 datë 29.01.2015, ashtu që Gjykata e Apelit konform dispozitave të nenit 365 të KPP, të akuzuarin:

M.P., me shënime si në shkresat e lëndës e shpall

FAJTOR

sepse si person zyrtar dhe atë gjyqtar pranë Gjykatës Komunale në Gjilan, ka kërkuar përfitim pasuror për vete për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij zyrtar të cilin veprim ai është dashur ta kryej, në atë mënyrë që si gjyqtar i çështjes të evidentuar pranë Gjykatës në fjalë, me numër R.nr.53/12, çështje kjo e iniciuar me propozim të palëve D.N. nga fshati ..., përcaktimin e kujdestarisë, kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të mitur, e nga ky i fundit për marrjen e vendimit sipas propozimit të parashtruar, të cilin vendim ai është dashur ta marr lidhur me këtë çështje, me datë 31.10.2012 nga pala D.N. kërkon shumën e të hollave prej 2.000 (dymijë) euro, me ç rast me datën 06.11.2012 fillimisht merr shumën prej 1.200 franga zvicerane në apo ena 1x1000 me numër serik 96B1151026 dhe 1x200 me numër serik 06B0688859, të cilën shumë ia dorëzon me kërkesë të pandehurit në fshatin ... dhe të cilat bankënota me datë 07.11.2012 edhe konfiskohen nga ana e zyrtarëve policor mu në shtëpinë e tij me rastin e kontrollit, ndërsa me datën 07.11.2012 rreth orës 10:45 minuta, në restorantin “NN” i cili gjendet në Gjilan, merr shumën tjetër në lartësi prej 1.200 franga zvicerane 1x1000 me numër serik 99M5513909 dhe 2x100 me numër serik 04E6735045 dhe 07J0506138 dhe pasi merr këtë shumë të hollave, këtu qytetarit D.N. ia dorëzon vendimin R.53/12 të dt. 07.11.2012, të holla këto të cilat vetëm pas pak çastesh mu në vendin e ngjarjes nga ana e zyrtarëve policor u gjetën në xhepin e palltos të pandehurit.

-me çka ka kryer veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 343 par.2 të KPK.

Andaj Gjykata e Apelit me aplikimin e dispozitave të neneve 41 dhe nenit 46 të KPRK, të akuzuarit i shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 07.11.2012 e gjer më 04.12.2012.

I akuzuari obligohet ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatësi dhe në emër të paushallit 50 euro, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari D.N. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil .

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin P.nr.82/2013 datë 29.01.2015, në bazë të dispozitës së nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së ka liruar nga akuza të akuzuarin M.P. për veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 343 par.2 të KPK-së. Shpenzimet e procedurës penale bien barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së Ligjit Penal, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin ta anuloj a ta kthej në rigjykim.

-Përgjigje në ankesën e Prokurorisë ka dhënë mbrojtësi i të akuzuarit av. Y.H. me propozim që aktgjykimi u kundërshtuar të vërtetohet ndërsa ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPP-së, për të cilën i njoftoj palët, e në të cilën nuk prezantoi Prokurori i Apelit, av. A.V. dhe i dëmtuari D.N., ndërsa prezent ishte i akuzuari M.P., mbrojtësi i tij av. Y.H.. Mbrojtësi av. Y.H. mbeti në tërësi pran pretendimeve ankimore ndërsa i akuzuari përkrahu fjalët e mbrojtësit.

- Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.216/2015 të dt. 06.05.2015 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të aprovohet si e bazuar ndërsa përgjigja e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa e Prokurorit është e bazuar.

Prokuroria pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPP, ngase dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin, ndërsa ajo që thuhet në arsyetim lidhur me faktet vendimtare është në kundërshtim me përmbajtjen e provave në shkresa të lëndës e me provat e administruara. Se është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendja faktike pasi nga masat e fshehta te hetimit dhe vëzhgimit janë dëshmuar veprimet inkriminuese të akuzuarit e cila është e mbështetur edhe me dëshminë e policit hetues V.R. e po ashtu edhe atë të të dëmtuarit D.N..

Përkritazi me bazën ankimore vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ne ankesë nuk kontestohen faktet të cilat i ka vërtetuar gjykata e shkallës së

parë, por kontestohen vetëm konkludimet, mënyra si i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë provat e administruara.

Gjykata e Apelit gjen se në këtë çështje juridik-penale gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, nuk ka ngelë asnjë rrethanë relevante pa u vërtetuar, mirëpo në praninë e fakteve të vërtetuara gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar Ligjin Penal kur të akuzuarin e ka liruar nga aktakuza me arsyetim se nuk është provuar se e ka kryer veprën penale me të cilën është akuzuar.

Kështu nga aktgjykimi i ankimuar si dhe shkresat në këtë çështje nuk janë kontestuese faktet se i akuzuari ishte person zyrtarë dhe atë gjyqtarë pranë Gjykatës Komonale në Gjilan, i ngarkuar si gjyqtar i çështjes të evidentuar pranë Gjykatës në fjalë, me numër R.nr.53/12, çështje kjo e iniciuar me propozim të dëmtuarit D.N. nga fshati ... , për caktimin e kujdestarisë, kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të mitur. I akuzuari si gjyqtarë i autorizuar për nga natyra e punës për këtë çështje është dashur të kryej veprimin zyrtarë në kuadër të autorizimeve të tij lidhur me propozimin e parashtruar të dëmtuarit për kujdestari të dëmtuarit me datë 07.11.2012 kanë marrë vendimin meritor R.nr.53/12. Nuk ishte kontestuese se me datë 06.11.2012 nga pala D.N. në fshatin ...ka pranuar shumën e të hollave prej 1.200 franga zvicerane në apo ena 1x1000 me numër serik 96B1151026 dhe 1x200 me numër serik 06B0688859, ndërsa të nesërmen me datë 07.11.2012 rreth orës 10:45 minuta, në restorantin “NN” i cili gjendet në Gjilan, i akuzuari nga e njëjta palë ka marrë shumën tjetër në shumë prej 1.200 franga zvicerane 1x1000 me numër serik 99M5513909 dhe 2x100 me numër serik 04E6735045 dhe 07J0506138 pasi ia ka dorëzuar vendimin R.53/12 të datës 07.11.2012, vendim ky të cilin e kishte marrë në gjykatë në të njëjtën ditë.

Ajo qka mbetet kontestuese janë faktet e kontestuar nga Prokurori se këto të holla i akuzuari a i ka marrë hua siç ka konkluduar gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e kundërshtuar e nëse po kërkesa për hua nga personi zyrtarë pra gjyqtari i çështjes nga pala propozues në procedurë a lejohet në kontest të rrethanave të rastit konkret kur i akuzuari është dashur të kryej veprimin zyrtarë në kuadër të autorizimeve të tij lidhur me propozimin e parashtruar të dëmtuarit për kujdestari.

Kështu nga shkresat e çështjes rezulton se në bazë të aplikimit të masave të fshehta të Prokurorisë në Gjilan PPN.nr.272/2012 të dt. 07.11.2012 të konfirmuara nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, nga dëshmia e dëshmitarit V.R. si polic hetues në Sektorin e Hetimeve të Korrupsionit në Gjilan, janë provuar faktet vendimtare se pala – i dëmtuari D.N. ka paraqitur rastin si kërkim ryshfeti nga i akuzuari si person zyrtar. Me të drejtë Prokurori thekson se gjykata e shkallës së parë gabimisht i ka vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve. Të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve kryesisht familjarë të akuzuarit çoftë nga familja e ngushtë apo nga vija e miqësisë, vërtetojnë tezën e mbrojtjes së të akuzuarit se te hollat e marra nga pala – i dëmtuari i ka kërkuar në formë huaje e që këtë në një mënyrë nuk e konteston edhe punëtori social dhe sekretarja teknike e të akuzuarit të cilët nuk mohojnë se kanë dëgjuar se pala – i dëmtuari ka përmend fjalën hua. Mirëpo, këto nuk ndikuan që Gjykata e Apelit ti vlerësoj ndryshe këto dëshmi sidomos në kontekst të personalitetit të akuzuarit kur si gjyqtarë i çështjes duke pasur të njohur se vendimet palëve nuk u dorëzohen personalisht në kafene por përmes sektorit të dedikuar për ekspeditimin e shkresave vepron kundër këtyre rregullave e që ndoshta në mungesë të rrethanave tjera do të nënshtrohej përgjegjësisë për shkelje disiplinore të kodit të etikës së gjyqtarëve. Por, në rastin konkret kur i akuzuari një ditë para marrjes së vendimit pranon nga pala të holla, e të nesërmen prapë pas marrjes së vendimit pranon të holla dhe këtë vendim (i

kryer në kuadër të autorizimeve të tij si në veprim zyrtar të cilin ai është dashur ta kryejë) ia dorëzon personalisht në dorë, tregojnë se në sjelljet e të akuzuarit përmbledhen të gjitha elementet objektive e subjektive të veprës penale të marrjes së rryshfetit nga neni 343 par.2 të KPK e marrjes së përfimit për kryerjen e veprimit zyrtarë e jo të huas. I akuzuari duke pasur parasysh se ka qenë gjyqtarë është dashur të dijë se integriteti i tij moral e profesional prej gjyqtari assesi nuk lejon transaksione financiare mes gjyqtarëve e palëve të procedurë qofshin ato edhe në formë të huas e cila hua po të kishte qenë vërtetë hua në baza familjare si pretendon i akuzuari atëherë parashtrohet pyetja cila ishte arsyeja që i dëmtuari ta denoncojë. Pretendimi i të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij se tëra kjo ka qenë montim nga i dëmtuari meqë nuk kishte mbështetje nga provat e proceduara nga gjykata e shkallës së parë dhe nga shkresat e lëndës, ngeli vetëm një supozim i tyre i pavërtetuar me prova.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të fakteve Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, mirëpo nuk ka aplikuar drejtë Ligjin Penal. Gjykata e shkallës së parë në rastin konkret e ka shkel ligjin në favor të akuzuarit ngase në praninë e këtyre fakteve gabimisht ka vlerësuar se duhet ta liroj nga akuza.

Gjykata e Apelit gjen se në veprimet juridiko penale të akuzuarit M.P. të cilat me aktakuzën e Prokurorit i janë vënë në barrë, e të cilat në bazë të gjendjes në aktgjykimin e kundërshtuar përtej dyshimit të bazuar u vërtetuan se i ka ndërmarrë, përmbledhen të gjitha tiparet objektive e subjektive të veprës penale Marrja e rryshfetit nga neni 343 par.2 të KPK, kështu kjo Gjykatë ka aprovuar ankesën e prokurorit dhe ndryshoi aktgjykimin e kundërshtuar duke shpall të akuzuarin fajtor për kryerjen e kësaj veprë penale për të cilën nga gjykata e shkallës së parë ishte liruar nga akuza, sepse si gjyqtarë i çështjes nga pala e çështjes kërkon përfitim në të holla për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij në veprim zyrtarë të cilin ai është dashur ta kryejë.

Me rastin e marrjes së vendimit për dënim, kjo Gjykatë ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform dispozitës së nenit 64 të KPK duke marrë parasysh si rrethana lehtësuese se më parë nuk ka qenë i gjykuar, gjendjen familjare e ekonomike të rënduar e duke mos gjetur rrethana rënduese, të njëjtit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se si në dispozitiv bindur se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit, vlerës së mbrojtur, rrezikshmërisë shoqërore të këtij llojit të veprave penale dhe se me dënimet e këtilla të shqiptuara në tërësi pritët të arrihet qëllimi i ndëshkimit të paraparë me nenin 34 të KPK të aplikueshëm. Paraburgimi në dënimin e shqiptuar i është llogaritur në dënim konform nenit 73 par.1 të KPPK të aplikueshëm ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësore është bazuar në dispozitën e nenit 99 dhe 102 të KPPK të aplikueshëm e udhëzimi i të dëmtuarit në kontest civil u morë në bazë të nenit 112 par.1 të KPK.

Ngase u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 403 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.521/17, më 12.12.2017

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____